



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit të nenit 104 paragrafi 6, nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 1.24 dhe nenit 28 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 32 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, si dhe nenit 30 të Rregullores Nr.03/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 28 korrik 2022,

Miratton:

**RREGULLOREN NR. 08 /2022  
PËR TRANSFERIMIN E GJYQTARËVE**

**Neni 1  
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Këshilli për nevoja dhe me qëllim të menaxhimit efikas dhe administrimit efektiv të drejtësisë, për të trajtuar në kohë të arsyeshme dhe në mënyrë proporcionale lëndët brenda sistemit gjyqësor, përmes kësaj rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e transferimit të një gjyqtari nga gjykata transferuese në gjykatën e transferimit, të të njëjtit nivel.
2. Këshilli dhe të gjithë gjyqtarët e gjykatave të Republikës së Kosovës zbatojnë dispozitat e kësaj rregullore.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1. **Këshilli** -Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
  - 1.2. **Gjykata transferuese** – gjykatën apo degën nga e cila transferohet gjyqtari.
  - 1.3. **Gjykata e transferimit** – gjykatën apo degën në të cilën transferohet gjyqtari.
  - 1.4. **Transferim** - lëvizjen e gjyqtarëve nga një gjykatë apo degë në gjykatën apo degën tjetër të të njëjtit nivel, duke respektuar kushtet e parapara me Ligjin për Gjykatat.

- 1.5. **Rrethanë e jashtëzakonshme**- paraqet gjendjen e krijuar në mënyrë të paparashikuar në një apo disa gjykata / degë përkatëse që kërkon zgjidhje të menjëhershme nga Këshilli me qëllim të evitimit të pasojave që mund të shkaktohen nga kjo gjendje;
- 1.6. Fjalët e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

## KAPITULLI II

### TRANSFERIMI I GJYQTARIT

#### Neni 3 Llojet e transferimit

1. Transferimi i gjyqtarit mund të jetë:
- 1.1. **Transferim i rregullt** - realizohet me vendim të Këshillit, për periudhën kohore deri në një (1) vit, për të ndihmuar gjykatën e transferimit në rastet kur ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e lëndëve apo me qëllim të ngritjes së efikasitetit.
  - 1.2. **Transferim i jashtëzakonshëm** - realizohet me vendim të Këshillit, për periudhën kohore deri në një (1) vit duke u bazuar në rrethanat e jashtëzakonshme në pajtim me këtë rregullore me mundësi vazhdimi edhe për një vit shtesë.
  - 1.3. **Transferim i përhershëm** - realizohet pa ndonjë kufizim kohor për gjyqtarin, i cili transferohet nga gjykata transferuese në gjykatën e transferimit të të njëjtit nivel, sipas konkursit të shpallur nga Këshilli, duke respektuar kushtet e veçanta për gjyqtarë, të parapara me Ligjin për Gjykatat.

#### Neni 4 Transferimi i rregullt

1. Në rastet kur Këshilli përcakton se një gjykatë ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e lëndëve apo me qëllim të ngritjes së efikasitetit mund të transferoj një gjyqtar me apo pa vullnetin e tij nga gjykata transferuese në gjykatën e transferimit të të njëjtit nivel, në kohëzgjatje deri në një (1) vit.

2. Përcaktimi i nevojës për transferim të rregullt të gjyqtarëve në gjykatën e transferimit bëhet, nga Këshilli, bazuar në rrethanat si në vijim:

- 2.1. dallimi proporcional në mes të numrit të lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura;
- 2.2. numri i përgjithshëm i lëndëve në punë në gjykatën apo degën përkatëse si dhe numri i lëndëve të vjetra;
- 2.3. mbi ngarkesa e gjyqtarëve me lëndë në gjykatën apo degën përkatëse;
- 2.4. në rast të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve si rezultat i përfundimit të mandatit të gjyqtarit.

**Neni 5**  
**Transferimi i jashtëzakonshëm**

1. Në rastet kur Këshilli përcakton se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme sipas nenit 2 të kësaj rregullore, me vendim të arsyetuar, mund të caktoj transferimin e jashtëzakonshëm të gjyqtarit me apo pa vullnetin e tij për një periudhë deri një (1) vit, me mundësi vazhdimi të transferimit edhe për periudhën kohore deri në një (1) vit shtesë.

2. Në secilin rast periudha e përgjithshme e transferimit të jashtëzakonshëm nuk mund të kalojë afatin prej dy (2) viteve.

**Neni 6**  
**Rastet specifike të angazhimit të gjyqtarit të transferuar**

Përfundimisht nga neni 4 dhe 5 të kësaj rregullore, gjyqtari i transferuar sipas nevojave të gjykatës apo degës përkatëse në të njëjtën kohë mund të punoj në gjykatën transferuese dhe në gjykatën e transferimit.

**Neni 7**  
**Transferimi i përhershëm**

1. Transferimi i përhershëm i gjyqtarëve bëhet përmes konkursit të brendshëm të shpallur nga Këshilli për pozita të lira.

Konkursi duhet të përcaktojë gjykatën, degën, departamentin dhe numrin e vendeve të lira që duhet të plotësohen me gjyqtarë me anë të transferimit.

**Neni 8**  
**Kriteret për transferim të përhershëm**

1. Gjyqtari i cili është kandidat për transferim të përhershëm duhet të plotësojë kriteret si në vijim:

1.1. të jetë gjyqtar me mandat të përhershëm;

1.2. t'i plotësojë kushtet e veçanta për gjyqtar në gjykatën, degën, departamentin e transferimit siç parashihen në Ligjin për Gjykatat;

1.4. të jetë i profilizuar në lëminë përkatëse që kërkohet në gjykatën e transferimit;

1.5. vendbanimin e kandidatit.

2. Përfundimisht paragrafit 1 i këtij neni, Këshilli për nevoja dhe shkaqe të arsyeshme mund të transferojë edhe një kandidatë gjyqtar me mandat fillestar por me kusht që i njëjti të ketë të përfunduar trajnimin fillestar.

## Neni 9

### Procedurat lidhur me transferimin e përhershëm

1. Të gjithë gjyqtarët e interesuar për transferim të përhershëm duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit në Këshill, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të konkursit.
2. Këshilli brenda tridhjetë (30) ditëve do të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e dorëzuara për të përcaktuar nëse kandidatët i plotësojnë kriteret për transferim, të parashikuara me ligj dhe me këtë rregullore.
3. Këshilli pas shqyrtimit të aplikacionit me shumicën e votave të anëtarëve të tij do të vendosë:
  - 3.1. të aprovojë kërkesën për transferim të përhershëm të një gjyqtari; ose,
  - 3.2. të refuzojë transferimin e përhershëm të një gjyqtari.

## Neni 10

### Përmbajtja e vendimit të Këshillit për transferim

1. Vendimi për transferim të rregullt duhet të përmbajë elemente si në vijim:
  - 1.1. të dhënat lidhur me gjykatën transferuese dhe të transferimit;
  - 1.2. të dhënat lidhur me gjyqtarin;
  - 1.3. departamentin dhe divizionin në të cilin gjyqtari transferohet;
  - 1.4. kohëzgjatjen e transferimit;
  - 1.5. arsyetim për nevojën e transferimit;
  - 1.6. nënshkrimin e kryesuesit të Këshillit.
2. Vendimi për transferim të jashtëzakonshëm duhet të përmbajë elemente si në vijim:
  - 2.1. të dhënat lidhur me gjykatën transferuese dhe të transferimit;
  - 2.2. të dhënat lidhur me gjyqtarin;
  - 2.3. departamentin dhe divizionin në të cilin gjyqtari transferohet;
  - 2.4. kohëzgjatjen e transferimit;
  - 2.5. arsyetim për ekzistencën dhe vazhdimin e rrethanave të jashtëzakonshme;
  - 2.6. nënshkrimin e kryesuesit të Këshillit;
  - 2.7. këshillën juridike në rast se transferimi kalon periudhën kohore me shume se një (1) vit.
3. Vendimi lidhur me kërkesën për transferim të përhershëm duhet të përmbajë elemente si në vijim:

- 3.1. të dhënat lidhur me gjykatën transferuese dhe të transferimit;
- 3.2. të dhënat lidhur me gjyqtarin;
- 3.3. mënyrën e vendosjes;
- 3.4. departamentin dhe divizionin në të cilin gjyqtari transferohet në rastet kur kërkesa është aprovuar;
- 2.5. arsyet për aprovimin ose refuzimin e transferimit;
- 2.6. nënshkrimin e kryesuesit të Këshillit;
- 2.7. këshillën juridike.

### **Neni 11** **E drejta në ankesë**

1. Gjyqtari ka të drejtë ankesë kundër vendimit të Këshillit për transferim të përhershëm apo transferim të jashtëzakonshëm që tejkalon periudhën një (1) vjeçare, në Gjykatën Supreme përmes Këshillit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimi të vendimit.
2. Vendimi i Gjykatës Supreme në procedurën ankimore sipas paragrafit 1 të këtij neni është vendim përfundimtar.

### **Neni 12** **Obligimet e Këshillit në rastet e transferimit të gjyqtarëve**

1. Këshilli në bashkëpunim me gjykatën e transferimit siguron kushtet e domosdoshme për punë të gjyqtarit të transferuar.
2. Këshilli siguron udhëtimin e gjyqtarit që transferohet sipas nenit 4 apo 5 të kësaj rregullore.
3. Koha të cilën gjyqtari i transferuar sipas nenit 4 apo 5 të kësaj rregullore e kalon në udhëtim, konsiderohet kohë e kaluar në orar të punës.

### **Neni 13** **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr. 15/2016 për Transferim dhe Caktimin e Gjyqtarëve dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që bien ndesh me këtë rregullore.

### **Neni 14** **Dispozitat kalimtare**

1. Për të gjitha procedurat lidhur me transferimin e gjyqtarëve që janë në zhvillim e sipër e të cilat nuk kanë përfunduar, me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore do të zbatohen dispozitat e kësaj rregullore.

2. Dispozita e nenit 8 paragrafi 2 i kësaj rregullore, do të zbatohet vetëm për periudhën kohore prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj rregullore.


### **Neni 15** **Shtojcat e rregullores**

1. Shtojca që i është bashkangjitur kësaj rregullore, është pjesë përbërëse e saj:

1.1.Shtojca 1: Formulari i aplikimit për transferim të përhershëm të gjyqtarit.

### **Neni 16** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 01 . 08 . 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**FORMULAR I APLIKIMIT PËR TRANSFERIM TË PËRHERSHËM TË GJYQITARIT**

Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Data e kërkesës:

00/00/0000

(dd/mm/vvvv)

Të dhënat për gjyqtarin:

(Shëno emrin dhe mbiemrin)

Gjykata transferuese

(Shëno gjykatën apo degën në të cilën aktualisht punoni)

Gjykata transferimit

(Shëno gjykatën, degën, departamentin dhe divizionin në të cilën dëshironi të transferoheni)

A keni bërë më herët kërkesë për transferim?  Po  Jo

(Nëse po, shënoni detajet)

Cili është statusi i emërimit tuaj?  Gjyqtar me mandat fillestarë; apo  Gjyqtar me mandate të përhershëm

I KUPTOJ KRITERET DHE PËRCAKTIMET E PARAPARA PËR POZITËN QË APLIKOJ,  
DHE PAJTOHEM QË:

1. Transferimi do të bëhet **vetëm** për pozitën e shpallur si të lirë;
2. Transferimi presupozon se gjyqtari/ja t'i plotësoj kriteret dhe kushtet për pozitën në të cilën kërkohet transferimi;
3. Aplikim i veçantë bëhet për secilën pozitë të shpallur.

(nënshkrimi i aplikuesit)

vendi dhe data: \_\_\_\_\_, 00/00/0000